


Indeksi i Konkurrueshmërisë Globale (GCI) përcjell performancën e 137 vendeve në 12 shtylla kryesore të konkurrueshmërisë. Ai vlerëson faktorët dhe institucionet e identifikuar nga kërkimi teorik dhe empirik si përcaktues të përmirësimeve në produktivitet dhe gjithashtu si përcaktuesi kryesor i rritjes ekonomike afatgjatë.

Raporti i Konkurrueshmërisë Globale ka një rëndësi të veçantë pasi ai ndihmon vendimmarrësit të kuptojnë natyrën komplekse dhe të shumëllojshme të sfidës së zhvillimit; të hartojnë politika më të mira të bazuara në bashkëpunimin publik-privat; dhe të ndërmarrin veprime për të rivendosur besimin në mundësitë e progresit të vazhdueshëm ekonomik.

Avantazhi i Indeksit të Konkurrueshmërisë është multidimensionaliteti i tij, duke mbajtur parasysh shumë faktorë që ndikojnë konkurrueshmërinë e një vendi. Raporti përmban profile të detajuara për 137 vende të përfshira në studim, renditjen globale të vendeve dhe renditjen e vendeve sipas çdo komponenti të indeksit. Indeksi, dhe komponentët e indeksit vlerësohen me një shkallë nga 1 (dobët) në 7 (shumë mirë).

Figura 1: Rezultati Sipas Komponentëve Kryesorë të Indeksit (renditja botërore)



Shqipëria është renditur në vendin e 75-të nga 137 të tilla gjithsej për sa i përket konkurrueshmërisë kombëtare, përcaktuar si tërësia e institucioneve, politikave dhe faktorëve që përcaktojnë nivelin e produktivitetit të një vendi në krahasim me klimën globale.


Kështu, vendi ka marrë një vlerësim prej 4.18 pikësh në totalin e indeksit, duke shënuar një performancë relativisht të mirë. Të gjithë komponentët e indeksit janë të listuar tek Figura 1, duke paraqitur edhe renditjen e vendit sipas çdo komponenti.

Performanca më e mirë për sa i përket komponentëve të indeksit është Shëndetësia dhe Arsimi Fillor, me 6.2 pikë, duke u renditur të 36-tët në renditjen botërore. Të tjerë komponentë të cilët kanë një performancë të mirë janë Arsimi i Lartë dhe Trajnimet, me 4.8 pikë, duke u renditur në vendin e 49; Eficienca e Tregut të Produkteve, me 4.4 pikë, duke u renditur në vendin e 57-të.

## Shqipëria përballë Vetes dhe Rajonit

Performanca më e keqe për sa i përket komponentëve të indeksit është Madhësia e Tregut, me 3.0 pikë, duke u renditur të 105-tët, pra me një treg relativisht shumë të vogël. Gjithashtu vlerësim të ulët ka marrë edhe Infrastruktura, me vetëm 3.6 pikë dhe duke u renditur në vendin e 94 – t, si Eficienca e Tregut të Punës, e vlerësuar me 4.0 pikë, por të renditur në vendin e 91 – të.

Figura 2: Rezultatet ndër vite



Duke bërë një krahasim me vlerën e mëparshme të indeksit, vëmë re se vendi ka patur një përmirësim. Indeksi për vitin 2012 – 2013 ishte 3.9, dhe Shqipëria renditej e 89 - ta nga 144 vende të marra në studim, ndërkohë që dy vite më pas, 13 – 14 dhe 14 – 15, vendi pati një përkeqësim në lidhje me indeksin, duke shkuar në 3.8 të dy vitet dhe duke u renditur të 95 - tët nga 148 vende dhe më pas të 97 - tët nga 144 vende.

Përmirësimi erdhi në vitin 2015 – 2016, ku indeksi pati një rritje të lehtë në 3.9 dhe një vit më vonë në 4.1, duke u renditur të 93 – tët nga 140 vende dhe të 80 nga 138 vende. Ky vit pasqyrooi edhe një ruajtje të trendit përmirësues të këtij indeksi.

Për sa i përket rajonit Shqipëria mban një pozicion më të favorshëm se vendet e tjera. Si fillim duhet të marrim parasysh se Maqedoni dhe Kosova nuk janë të përfshira në këtë raport, të cilat siç shpjegohet në raport kanë mangësi të konsiderueshme të dhënash për shtyllat kryesore të indeksit.

Në raport me, Bosnje & Hercegovinën, Malin e Zi dhe Serbinë, Shqipëria ka vlerën më të madhe të indeksit, duke u renditur kështu i pari në rajon në indeksin e konkurrueshmërisë. Pas Shqipërisë vjen Mali i Zi, me vlerë indeksi 4.15 dhe i renditur i 77 – ti, ndjekur më pas nga Serbia e 78 – ta, me vlerë indeksi 4.14. Ndërkohë që Bosnje & Hercegovina ka një vlerë relativisht më të ulët, 3.87 dhe është e renditur e 103 – ta, apo e fundit e rajonit.

Figura 2: Rezultatet e Vendeve të Rajonit

